

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vajza e Salih Mustafës: Drejtësia e vërtetë s'mund të barazojë ushtarët çlirimtarë me xhelatët serbë
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/vajza-e-salih-mustafes-drejtesia-e-vertete-smund-te-barazoje-ushtaret-clirimtare-me-xhelatet-serbe
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:29:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 13:34:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ca991dab7cb4c5d677fbdadcc9e357d67a545616738d81e7df6d6c8220653840
TEKSTI	60fcbd2b33b5a515e8901efc81bb490840f62ffb075092d3681fddae0327d67e
PAMJA	56767c79a9fd87460c8c840d9d0730ad35dfced047fd9ae4a48370ae91308d84

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	784ad418e8838170738e83fbc5dd59e084c8ad874756f67535aeb4d5dee6dae0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/784ad418e8838170738e83fbc5dd59e084c8ad874756f67535aeb4d5dee6dae0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Vajza e Salih Mustafës: Drejtësia e vërtetë s'mund të barazojë ushtarët çlirimtarë me xhelatët serbë



12 shtator 2026 15:34

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

“UÇK-ja nuk ka qenë rastësi, por ka qenë domosdoshmëri historike.” Ishte një nga mesazhet e Buna Mustafës, vajzës së Salih Mustafës – Calit, në “Marshi për Liri” që u mbajt sot në Prishtinë.

Duke folur para qytetarëve të mbledhur në kryeqytet, Mustafa tha se me kalimin e viteve “mendjet po kthjellohen” dhe se, sipas saj, e vërteta për luftën e UÇK-së po bëhet gjithnjë e më e qartë.

Ajo foli për sakrificën e ushtarëve të UÇK-së dhe kundërshtoi çdo përpjekje për të barazuar luftën çlirimtare me krimet e kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë.

“Ditët po kalojnë, vitet po ndërrohen, mendjet po kthjellohen, por edhe e vërteta çdo ditë më shumë po ndriçohet. Se UCK nuk ka qenë rastësi, por ka qenë domosdoshmëri historike. Një ushtri që u zgjua nga populli dhe krijoi uniformën e vet, me të cilën nuk terrorizoi asnjë civil, nuk dhunoi e nuk abuzoi me asnjë grua e asnjë fëmijë të përkatësisë tjetër. Prandaj, nderoj emblemën e vet, përkundër regjimit fashist serb që na i shkaktoi për mbi 13 mijë viktima civile, na i vrau e na i masakroi 1 mijë e 400 fëmijë. Dhunoi e abuzoi seksualisht me 20 mijë nëna e motra tonat. I zhdukuri 1 mijë e 500 bashkëqytetarë dhimbjen e të cilëve familjet e tyre nuk mundën ta shuajnë dot kurrë. Kreu 400 masakra rreth e këmbë Kosovës. Krijuan varreza masive të shqiptarëve që edhe në ditët e sotme po zbulohen, na shkaktuan dëme kolosale materiale në vendin tonë. Andaj, hendeku është aq i madh sa që drejtësia e vërtetë nuk mund të barazojë kurrë ushtarët çlirimtarë me xhelatët serbë. Nuk mund të barazojë kurrë ata që sollën lirinë me ata që kryen gjenocid. Para drejtësisë së vërtetë do të jemi gjithmonë të pastër dhe shpirti i bardhë i ushtarëve tanë do të mbetet përgjithmonë i padiskutueshëm”, tha ajo.

Vajza e Salih Mustafës kritikoi gjithashtu përdorimin e luftës së Kosovës për interesa politike dhe përplasje mes individëve apo grupeve të interesit, duke thënë se një gjë e tillë nënkupton goditje ndaj themeleve të lirisë.

“Të hedhësh në pazaret e Evropës luftën tonë për interesa të ulëta, apo për qërim hesapësh, mes individëve apo grupeve të interesit, është si të luash dorën e djallit. Kjo do të thotë se ata po mundohen të godasin themelet e lirisë tonë duke i kryqëzuar ushtarët tanë të lirisë. Por çlirimtarët tanë e dinin më së miri se çfarë është jeta dhe liria. Ata ishin të gatshëm të vdisnin për të, dhe disa edhe vdiqën, që ne të gjallët që jemi sot këtu, të jetojmë me respekt dhe me dinjitet, dhe jo kokëulur, me nënshtrim dhe

Futboll.

City me një futbollist më pak, ndëshkohet
Foden

Shtojca për Kulturë.

“Bota serbe” deri te propaganda për fajësimin e viktimave

Futboll.

Kapitenia e Kosovës shkëlqen në Bundesligën e Gjermanisë

Futboll.

Ronaldo reagon për skandalin në Arabinë Saudite

Botë.

Policia turke ndalon dhjetëra persona gjatë bastisjeve kundër LGBTQ+

Sporte të tjera.

Antonelli fiton edhe në Spanjë

me tike. Ata njohën mirë dhe përcaktuan paqen, mbajtën rapetin ashtu si e mbajtën edhe pushkën, sollën lirinë, sepse e kishin përjetuar robërinë. Çlirimtarët, si Hashim Thaqi, Kadri Vesli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Pjetër Shala e Salih Mustafa ishin njerëzit e duhur në momentin e duhur, në një histori qind vjeçare të përpjekjeve për autonomi, ishin ata që sollën lirinë. Fjalimin tim dua të mbyll me thënien e babait tim “Lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e domosdoshme dhe e pashmangshme. Çlirimtarë ju presim”, tha ajo. /KP

LEXO PËRDITËSIMET TJERA



Mijëra qytetarë marshojnë në mbështetje të ish-udhëheqësve të UÇK-së

#BUNA MUSTAFA

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 23 o. më parë
Kosova i kërkon Hagës lirinë e
çlirimtarëve



Arbëri • 12 sht 2026
E bija e dëshmorit Bajram Sylejmani
kërkon drejtësi për ish-krerët e UÇK-së



LAJMET E MBRËMJES • 8 sht 2026
“Liria ka emër” shpall të pafajshëm ish-
krerët e UÇK-së



Arbëri • 25 kor 2026
Krasniqi: 16 shtatori do të dëshmojë
pastërtinë e luftës së UÇK-së



Arbëri • 11 qer 2026
Veteranët në marshin e UÇK-së kërkojnë
lirinë e ish-krerëve në Hagë: Lufta jonë
ishte e drejtë

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzimi për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.